



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT**

N J O F T I M

***PËR ZHVILLIMIN E TESTIMIT TË INFORMATIZUAR TË KUALIFIKIMIT TË
PUNONJËSVE ARSIMORË PËR KATEGORINË “MËSUES I KUALIFIKUAR”
VITI SHKOLLOR 2025 - 2026***

Në zbatim të të Udhëzimit nr. 17, datë 22.07.2024, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë”, i ndryshuar, si dhe shkresës së Ministrisë së Arsimit, nr. 894/1 prot., datë 30.01.2026 me lëndë: “Kualifikimi i mësuesve për vitin shkollor 2025 - 2026”, ju informojmë se testimi i informatizuar do të zhvillohet në mesin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me adresë Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH), duke filluar nga java e dytë e muajit Mars 2026.

Ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar, kandidatët duhet të kenë parasysh rregullat e mëposhtme:

- a) të jenë të pajisur me mjet identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë, dokumenti origjinal);
- b) të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të testimit;
- c) të mos mbajnë dhe të mos përdorin celularë dhe mjete të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
- ç) të mos pinë duhan dhe të mos konsumojnë ushqime në mjediset e testimit;
- d) të mos komunikojnë me njëri-tjetrin gjatë zhvillimit të testimit.

Kalendari i organizimit të testimit dhe orari i pjesëmarrjes në testim për çdo kandidat, do të publikohen në vijim në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore www.qsha.gov.al.

Orari i pjesëmarrjes në testim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të mund të ketë ndryshime.

Ju urojmë Suksese!